



A.nr.2070/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, dhe Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2070/2025, të datës 24.12.2025, të parashtruar nga ankuesi V.H. nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.06.2026, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 05.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2070/2025, e datës 24.12.2025, e parashtruar nga ankuesi V.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, V.H. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 24.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimeve të Kryetarit të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike Postare dhe Drejtorit të Departamentit të Financave për reduktimin e dy ditëve të pushimit vjetor në kompensim të dy ditëve të pushimit mjekësor; Refuzimi i kërkesës për shfrytëzimin e tri ditëve të pushimit vjetor, akuza dhe vlerësim e tendencioze të pa argumentuar, mos interpretim ligjor i kërkuar sipas kësaj çështje, mos shqyrtim i ankesës nga ana e Komisionit Disiplinor dhe vazhdim i presionit nga Kryetari i Bordit,

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (tutje referuar ARKEP), ndërsa, kjo e fundit ka dërguar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me numër protokolli 8053/2025 të datës 24.12.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Emailin e datës 25.11.2025 nga N.R për F.G dhe ankuesin; Emailin e datës

21.11.2025 nga ankuesi për F.G dhe G.Z; Emailin e datës 24.11.2025 nga ankuesi për F.G; Raport i kontrollës mjekësore datë 21.11.2025; Emailin e datës 25.11.2025 nga F.G për ankuesin; Emailin e datës 25.11.2025 nga ankuesi për F.G dhe N.R; Kërkesën për pushim vjetor e datës 04.12.2025 nga ankuesi; Vendimin e datës 09.12.2025 të Komisionit Disiplinor të ARKEP; Ankesën e datës 01.12.2025 nga ankuesi tek Komisionit Disiplinor i ARKEP; Ankesën e datës 27.11.2025 nga ankuesi për Kryetarin e Bordit të ARKEP; Emailin e datës 27.11.2025 nga ankuesin për N.R; Kërkesën për pushim vjetor datës 25.11.2025; Vendimin e datës 09.12.2025 të Komisionit Disiplinor të ARKEP; Emailin e datës 02.12.2025 nga ankuesi për N.R; Emailin e datës 02.12.2025 nga N.R për ankuesin; Emailin e datës 24.11.2025 nga H.H për N.R dhe B.E; Raport i QKUK i datës 10.09.2025; Raport Mjekësor nga QKUK i datës 13.02.2025; Raport nga konsulta mjekësore datës 14.02.2025; Raport Specialistik i datës 10.02.2025; CV-në e ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.12.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 05.01.2026; Akt Emërimit e datës 13.06.2025; Kërkesën për pushim vjetor i datës 16.10.2025; Emailin e datës 10.02.2025, 13.02.2025, 14.02.2025,18.02.2025 nga ankuesi për F.G; Emailin e datës 21.03.2025 nga ankuesi për F.G, H.H, I.F; Emailin e datës 28.04.2025 nga ankuesi për N.R, F.G, I.F; Emailin e datës 08.05.2025, 23.05.2025, 19.06.2025 nga ankuesi për I.F dhe F.G; Emailin e datës 04.08.2025 nga ankuesi për F.G, N.R, I.F, H.H dhe G.Z.I; Emailin e datës 29.08.2025 nga ankuesi për F.G, NR. G.Z-I, M.B dhe B.D-E; Emailin e datës 23.09.2025, 06.11.2025 nga ankuesi për F.G dhe H.H; Emailin e datës 26.12.2025 nga Zyrtar i Lartë për Politika të Personelit në DMZP për F.G; Emailin e datës 02.12.2025 nga F.G për Q.B; Emailin e datës 02.12.2025 nga info.arkep për info.zip.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara, *sepse*:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokollit 109/1/25 të datës 13.06.2025, është i punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave në ARKEP.
- Ankuesi më datë 21.11.2025 ka njoftuar personat kompetent për mungesën në punë për shkaqe shëndetësore duke mos specifikuar kohëzgjatjen, njoftim të njëjtë ka bërë edhe më datë 24.11.2025, ndërsa më datë 25.11.2026 ka proceduar kërkesë për pushim vjetor në kohëzgjatje prej tri ditëve duke mos specifikuar saktë ditët e pushimit, kërkesë kjo e refuzuar për nënshkrim nga mbikëqyrësi, si më arsyetimin se kërkesa duhet të bëhet në afat se paku 15 ditësh.
- Më datë 25.11.2025, Kryetari i Bordit të ARKEP, si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit, përmes emailit ka kërkuar nga ankuesi dhe Drejtori i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme që të respektohet Rregullorja (QRK) Nr. 04.2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, ndërsa lidhur me pushimin mjekësor të ankuesit për datën 21.11.2025 deri 24.11.2025 (dy ditë), ka udhëzuar që këto ditë ti zëvendësohen më ditë të pushimit vjetor.
- Ankuesi më datë 01.12.2025 i është drejtuar më ankesë Komisionit Disiplinor të ARKEP, po më bazë të njëjtë ankimore sikurse në ankesën e pashtuar në Këshill.
- Komisioni Disiplinor më datë 09.12.2025, ka nxjerrë Vendimin me numër protokollit 189/1/25, me të cilin ka shpallur vetën jokompetent për të shqyrtuar ankesën e ankuesit të datës 01.12.2025.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Kryetari i Bordit të ARKEP, ka keqpërdor vendin e punës pasi që edhe përkundër faktit që kam qenë në pushim mjekësor këto ditë më janë zëvendësuar me ditë të pushimit vjetor, edhe pse për një ose dy ditë të pushimit mjekësor nuk janë sjell dokumentacion, mirëpo edhe përkundër kësaj kam ofruara dëshmitë e nevojshme. Në rastin tim është vepruar në mënyrë selektive në rastin e refuzimit të kërkesës për pushim vjetor me arsyetimin se nuk keni parashtruar kërkesë për pushim vjetor 15 ditë përpara, e që nuk ka ndodhur për asnjë zyrtar tjetër. Kërkon të konstatohet se është e drejtë shfrytëzimi i pushimit mjekësor dhe aspak abuzim me vendin e punës, të përcaktohet saktë nëse njëjtë është duke u vepruar me zyrtarët tjerë dhe të përcaktohet se zbatimi i kërkesës për pushim 15 ditë përpara përcaktohet vetëm për pushim vjetor për më shumë se 10 ditë.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit lidhur me të drejtën e zyrtarit publik në pushim iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjëshit nenit 21 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Orari i punës dhe pushimet e zyrtarës/it publik rregullohen në përputhje me legjislacionin përkatës për punë. 2. Kriteret dhe kushtet për zbatimin e këtij neni përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për Punë..”* e në ndërlidhje me këtë Kolegji mori parasysh nenin 37 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, ku përcaktohet: *3. Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, i punësuarit duhet ta njoftojë punëdhënësin më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor. 4. Me rastin e lejimit të pushimit vjetor, punonjësit i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor.*

Për me tepër, Kolegji i Këshillit i'u referua Rregullores në fuqi (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, respektivisht, nenit 4, 9, 10, 11 dhe 12 ku përcaktohet: **Neni 4.** *1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës zyrtari publik kryen punë ose shërbime në të mirë të institucioni. 4.2. Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës. ...”* **Neni 9 Pushimi vjetor:** *1. Zyrtari publik për çdo vit kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor me pagesë në një kohëzgjatje prej njëzet (20) ditë pune, pavarësisht nëse punon me orar të plotë apo të shkurtuar. 2. Zyrtari publik që punon në punët dhe detyrat e punës, për të cilat përkundër aplikimit të masave mbrojtëse nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme, ka të drejtë në pushim vjetor në kohëzgjatje së paku prej tridhjetë (30) ditë pune, për vitin kalendarik. 3. Zyrtarit publik i shtohet një (1) ditë pune pushim për çdo pesë (5) vite të përvojës së punës. 4. Nën ato prindi vetushqyes apo vetmbajtës i fëmijës deri në moshën tre (3) vjeçare, si dhe zyrtari me aftësi të kufizuar, përfitojnë dy (2) ditë punë shtesë në pushimin vjetor. 5. Në rastet kur zyrtari publik sëmuret gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor, koha e pushimit të lejuar mjekësor nuk llogaritet në pushim vjetor....* **Neni 10 Shfrytëzimi i pushimit vjetor** *1. Për intervalin kohor të shfrytëzimit të pushimit vjetor, zyrtari publik duhet ta njoftojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë më së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor. 2. Me rastin e lejimit të pushimit vjetor, zyrtarit publik i lëshohet vendim për orarin dhe kohëzgjatjen e pushimit vjetor më së paku pesë (5) ditë para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor. 3. Kërkesa për pushim vjetor miratohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe*

njoftohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. 4. Miratimi apo refuzimi i pushimit vjetor, evidentohet në dosjen individuale të zyrtarit publik. 5. Pushimi vjetor mund të shfrytëzohet në dy (2) apo më shumë pjesë, në marrëveshje me mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë. 6. Në qoftë se zyrtari publik e shfrytëzon në dy (2) apo me shumë pjesë pushimin vjetor, pjesa kryesore duhet të shfrytëzohet për së paku dhjetë (10) ditë pune të pandërprera gjatë një (1) viti kalendarik. Pjesa tjetër e pushimit të pashfrytëzuar duhet të shfrytëzohet jo më vonë se deri me 30 qershor të vitit të ardhshëm kalendarik. **..Neni 11 Pushimi mjekësor**

1. Zyrtari publik në rast të sëmundjes ka të drejtë për pushim mjekësor në kohëzgjatje deri njëzet (20) ditë punë brenda një (1) viti me kompensim 100% të pagës. 2. Zyrtari publik i cili e shfrytëzon pushimin mjekësor, duhet të informoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë dhe të ofrojë dëshminë përkatëse nga organi kompetent mjekësor. 3. Ditët e parapara për pushim mjekësor zyrtari publik mund ti shfrytëzojë edhe në rast të sëmundjes së fëmijës së tij, me dëshmi të organit mjekësor. 4. Zyrtari publik ka të drejtë për kompensim të pushimit mjekësor si pasojë e lëndimit në punë, ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin, në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në nëntëdhjetë (90) ditë pune me kompensim prej 70 % të pagës së tij. 5. Dëshmi nga organi kompetent mjekësor, sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, nënkupton dëshminë e cila përcakton qartë ditët e mungesës në punë për shkak të gjendjes së tij mjekësore. 6. Pas kalimit të periudhës me kompensim, sipas paragrafit 1 dhe 3 të këtij neni, zyrtari publik me rekomandimin e organit kompetent mjekësor ka të drejtë të vazhdojë pushimin mjekësor pa pagesë. 7. Për kohën e mungesës në punë pa pagesë nga paragrafi 6 i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës për kthim në vendin tij të punës.

Neni 12. 1. Iajmërimi për paaftësinë e përkohshme për punë 1. Në rast të sëmundjes ose paaftësisë së përkohshme për punë, zyrtari publik është i obliguar të informojë mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna.

Bazuar në kuadrin ligjor si më sipër e në kuptim të pretendimeve ankimore, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës ka gjetur se është fakt i pakontestueshëm që ankuesi përmes emailit zyrtar më datë 21.11.2025 dhe datë 24.11.2025, ka njoftuar për mungesë në punë për shkak të gjendjes shëndetësore, mirëpo, i njëjti më rastin e parashtrimit të kërkesës për aprovim të pushimit si dëshmi mjekësore ka ofruar një shkresë (letër) që mbanë datë të lëshimit 21.11.2024 nga Dr. Xhemajl Selmani dhe më rekomandimin për 10 ditë pushim mjekësor, ndërsa, nga shkresa respektive nuk vërtetohet së dokumenti a është lëshuar nga institucioni shëndetësor publik apo privat, pasi që kjo shkresë nuk përmban të dhëna identifikuese lidhur me institucionin. Andaj, mbi këto fakte, nuk gjen mbështetje pretendimi ankimor mbi këtë bazë, gjegjësisht se ankuesit i janë hequr dy ditë nga pushimi vjetor edhe pse ka qenë në pushim mjekësor, sepse, siç u konstatua më lartë ankuesi mungesën në punë për shkaqe shëndetësore për periudhën 21 deri 24 nuk ka arritur të argumentoj më dëshmi përkatëse mjekësore siç përcaktohet me nenin 11, paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, Rrjedhimisht, duke qenë së ankuesi nuk ka ofruar dëshmi bindëse mjekësore, atëherë, më të drejtë institucioni punëdhënës mungesën në punë për data 21 dhe 24 nëntor 2025 e ka konvertuar në ditë të pushimit vjetor.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për mos aprovim të tri ditëve të pushimit vjetor, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës ka vërtetuar së ankuesi menjëherë pas kthimit në punë më datë 25.11.2025, kishte parashtruar serish kërkesë për pushim vjetor prej tri ditëve duke filluar nga data 26.11.2025, mirëpo, kjo kërkesë nuk ishte aprovuar nga mbikëqyrësi i ankuesit për shkak së kërkesa nuk ishte bërë në afatin e përcaktuar më dispozita ligjore. Rrjedhimisht, Kolegji thekson faktin se qëndron konstatimi së në praktikën

institucionale nuk respektohet në përpikëri afati 15 ditor, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit dhe duke bazuar edhe në praktikën vendimmarrëse të Këshillit, duhet të ekzistojnë rrethana të mirëkuptimit në mes të zyrtarëve dhe stafit mbikëqyrës në atë mënyrë që ditët e pushimit të shfrytëzohen mbi bazë të marrëveshjes dhe së kërkesat për pushim vjetor të parashtrihen në një afat të arsyeshëm kohor, ndërsa, në rastin konkret, kërkesa është proceduar më datë 25 nëntor 2025 për pushim duke filluar nga data 26 nëntor (pra një ditë para ditës së pushimit).

Përkitazi me pretendimin e ankuesit për mos shqyrtim të ankesës nga Komisioni Disiplinor, Kolegji konstaton se një pretendim i tillë nuk gjënë mbështetje, mbi faktin se Komisioni Disiplinor është organ kompetent për trajtim të shkeljeve të rënda disiplinore të nëpunësve civilë, ndërsa, në rastet kur nëpunësi civil pretendon së i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, atëherë, i njëjti mund të ushtroj ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHC siç parashihet me nenin 27.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.*

Kolegji i Këshillit bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër, e në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“Neni 88 1. Organi publik, për të përcaktua gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen. Neni 89 Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ”,* konstaton se ankuesi nuk ka ofruar dëshmi që provojnë bazueshmërinë e pretendimeve ankimore si në ankesa, andaj, Kolegji në kuptim të nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2070/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit V.H;
- ARKEP: Kryetarit të Bordit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHC-së.